

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM –Divizioni penal, në përbërje nga gjyqtari individual Hysnije Gashi, me pjesmarrjen e sek juridike, Hajrije Arifi punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të pandehurit A.B. nga fshati , komuna e Kaçanikut për shkak të veprës penale rrezikimi I trafikut public nga neni 297 par 5 lidhur me par.1 të KPK-se sipas aktakuzës së ish Prokuroris Publike të Qarkut në Prishtinë PP nr.981-4/2009 të dt.23.11.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e prokurorit të ështëit, Bahri Hyseni, të pandehurit mbrojtësit. Av A.I. ,përfaqësuesi I të ndjerit , më dt. 30.03.2015 të njejtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.B. i biri i J. dhe H. , e gjinisë M. , data e lindjes...., në fshatin, komuna e Kaçanikut , ku edhe jeton ,i martuar baba i tre fëmijëve, shtetas i Republikës së Kosovës , ka të kryer shkollën e mesme , i gjendjes së mesme ekonomike , me parë i pa gjykuar..

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt.27.09.2009 rreth orës 15:20 minuta , në magjistralen Prishtinë – Kaçanik me të arritur përballë autoservisit “Burimi “, ka shkelur ligjin mbi trafikun publik neni 54.1 dhe ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, duke menduar me mendelehtësi se nuk do të shkaktoj pasoja të ndaluara ,në atë mënyrë që i pandehuri më veturën e tipit “Mercedes” me targa....., ka qarkulluar me një shpejtësi të lëvizjes 93.85 km /h dhe me të vëtejtur biçiklistin i sili ishte duke trupuar rrugën nga ana e majt në të djatht , përpiqet të frenoj automjetin , popr nuk arrinashtu që me pjesën e përparme të anës së djathte godet biçiklistin , tani ndjerin L.S. ku në atë çast i ndjeri hedhet mbi mbulojën e motorit duke e goditur me kokë parafangon e automjetit, e më pas ai është

dërguar në spitalin e Ferizajt për dhënjën e ndihmës së parë, e pastaj është dërguar edhe në QKUK në Prishtinë ku me datën 04.10.2009 ka ndërruar jetë.

-me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Gjykata në bazë të nenit 3, 6, 11, 16, 36, 38, 64, të KPK-së, dhe nen.365 të KPPK-së

G J Y K O N

Të akuzuarin.

A.B.

ME DËNIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 1 (një) vit ,të cilin denim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

Përfaqësuesi i të ndjerit L.S. , F.S. për realizimin e , kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë conform nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj shpenzimet e ekspertizës mjekoligjore në lartësi pre 70.-€, si dhe paushallin gjyqësore në shumën prej 20.-€,të gjitha këto në afat prej 15 ditësh,nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Ish Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë me akuzën PP nr.981-4/2009 të dt. 23.11.2012 ka ngarkuar të pandehurin A.B. nga fshati K.Kaqanikut , për shkak të vepres penale rrezikimi I trafikut public nga neni 297 par.5 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësorë me dt.30.03.2015. në të cilën përfaqësuesi .i akuzës – prokurori I shtetit Bahri Hyseni lexoj aktin akuzues, ku deri në fjalen përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë akuzes dhe kulifikimit juridik të vepres penale , duke I propozuar gjykatës që të njejtn ta shpallë fajtor dhe tia shqipëton dënimin e paraparë me ligj.Gjyqtari pasi që u bind se I pandehuri e ka kuptuar akuzen konformë nenit 325 të KPPK-së , të pandehurit I ofroi mundësinë të pranoj fajsinë ose të deklarohet I pafajshëm.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajsinë për veprën penale e cila I vihet në barrë .

Gjykata vlerësoi se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par. 1 të KPP pasi që I pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se një pranim i tillë është bërë vullnetarishtë dhe mbështetet në provat dhe materialet e prezentuara na prokurori shtetit siq janë: fotografit e vendit të ngjarjes , vërtetimi mjekësor per vdekje nr. /2009 të dates 29.09.2009 ekspertiza e komunikacionit e dates 06.10.2010 ,akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabim faktik, andaj Gjykata konform nenit 366 po atë ditë ka shpallur aktgjykimin.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e vepres penale rrezikim I trafikut public nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 1 të KPK .

Me rastin matjes e llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e tij në kuptim të nen. 64 të KPPK-së. , të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurit pendimin e thellë, për kryerjen e kësaj vepre penale, I pa denuar më pare për vepër penale se është pajtuar sipas dokeve zakonore me familjen e të dëmtuarit.

Kurse rrethanat rënduese gjykata vlersoi shkallen e rrezikshmërisë dhe peshen e kësaj vepre penale duke qenë e bindur se me dënimin e shqipëtuat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, arrihet qëllimi ndëshkimmor , si preventive speciale dhe gjenerale për të përmbajtur të pandehurin por edhe përsonat të tjerë në kryerjen e veprave penale, dhe kështu gjykata mendon se me këtë dënimi do të arrihet qëllimi ndëshkimmor I paraparë me nenin 41 të KPK-së.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë conform nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj shpenzimet e ekspertizës mjekoligjore në lartësi prej 55.-€, si dhe paushallin gjyqësore në shumën prej 20.-€,të gjitha këto në afat prej 15 ditësh,nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P.nr.901/12 të dt. 30.03.2015

Sek.juridike

Hajrije Arifi

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

G j y q t a r i

Hysnije Gashi